

Në bazë të nenit 20 të Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural ("Fl. Zyr. MZ", nr. 59/09, 18/11, 40/11, 34/14, 01/15, 30/17 dhe 51/17) dhe nenit 42, pika 1, paragrafi 2 i Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 05/07, 09/09 dhe 16/11), Kuvendi i Komunës së Ulqinit, me pëlqimin e Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural, në mbledhjen e mbajtur, më 18. 03. 2019 ka nxjerrë

VENDIM PËR MASAT STIMULUESE PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Vendim parashikohen llojet e stimulimit për përkrahjen e investimeve në zhvillimin e bujqësisë (në vazhdim: stimulimet), kushtet dhe mënyra e realizimit të të drejtave për stimulim, si dhe obligimet e shfrytëzuesit të stimujve.

Neni 2

Stimujt përfshijnë përkrahjen financiare të aktiviteteve që kanë të bëjnë me investimet në bujqësi me qëllim: të rritjes së cilësisë dhe konkurrencës së produkteve bujqësore; orientimin e prodhuesëve kah kushtet e tregut dhe standardeve; rritjen e numrit të të punësuarëve në bujqësi dhe rritjen e shfrytëzimit të resurseve bujqësore.

Neni 3

Mjetet për stimulimin e zhvillimit të bujqësisë sigurohen me Buxhetin e Komunës.

Me Buxhet mjetet e destinuara për stimulimin u ndahen shfrytëzuesve sipas Planit të shfrytëzimit të mjeteve për nxitjen e zhvillimit të bujqësisë, të cilin e nxjerrë Kryetari i Komunës së Ulqinit, më së voni në afat prej 30 ditësh, pas miratimit të Buxhetit të Komunës për vitin në vijim.

Plani i shfrytëzimit të mjeteve për nxitjen e zhvillimit të bujqësisë përmban të dhënat për mjetet e destinuara, përcakton shumat për disa lloje të stimulimit të paraparë me këtë vendim dhe afatet e shpalljes së thirrjes publike.

Neni 4

Mjetet e nxitjes ndahen në bazë të thirrjes publike (konkursit) për ndarjen e përkrahjes, që publikohen në së paku një gazetë ditore, në tabelën e shpalljeve dhe faqen e internetit të Komunës.

Për realizimin e të drejtave në stimulim vendosën organi kompetent për punë të bujqësisë (në vazhdim: organi kompetent), në mënyrën dhe procedurën e paraparë me këtë Vendim.

II. LLOJET E STIMULIMIT

Neni 5

E drejta për nxitjen në bujqësi realizohet përmes llojeve të mëposhtme të stimujve:

1. Mbështetja e prodhimit dhe zhvillimit të ullishtarisë,
2. Mbështetja e mbjelljes së bimëve mjekësore dhe aromatike,
3. Mbështetja e prodhimit të bimëve specifike të Ulqinit,
4. Mbështetja e organizimit dhe zhvillimit të prodhimtarisë bujqësore organike,
5. Mbështetja e prodhimit blegtoral,
6. Avancimin e bletarisë,
7. Administrimi i rreziqeve në bujqësi,
8. Promovimi i produkteve bujqësore dhe bujqësisë,
9. Mbështetja e investimeve për hapjen e pusave, cisternash dhe sistemeve për vaditje,
10. Mbështetja e bërjes së analizave të frutave të pemëve dhe perimeve.

Mbështetja e prodhimit dhe zhvillimit të ullishtarisë

Neni 6

Nxitjet përfshijnë:

- Mbështetje aktiviteteve që kanë të bëjnë me investime për avancimin e ullishtarisë,
- Mbjelljen e fidanëve të rinj të ullinjve.

Investimet e pranueshme

- Blerja e materialit mbjellës për krijimin e sipërfaqeve të reja me ullinj.

Kushtet e pranueshmërisë

Shfrytëzuesit duhen të jenë të regjistruar në regjistrin e prodhuesëve bujqësorë (ekonomi bujqësore) të Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural. Mbështetet krijimi i sipërfaqeve të reja me fidanë të ullinjve me sipërfaqe prej 0,10 deri në 0,30 ha.

Mbështetja e prodhimit dhe mbjelljes së fidanëve të bimëve medicinale dhe aromatike

Neni 7

Nxitjet përfshijnë mbështetjen e aktiviteteve që kanë të bëjnë me investimet për mbjelljen dhe ngritjen e fidanëve të bimëve medicinale dhe aromatike.

Investimet e pranueshme:

- Blerja e materialit mbjellës dhe
- Mbjellja e plantacioneve shumëvjeçare të bimëve medicinale dhe aromatike

Kushtet e pranueshmërisë

Shfrytëzuesit duhen të jenë të regjistruar në regjistrin e prodhuesëve bujqësorë (ekonomi bujqësore) të Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural. Shfrytëzuesit duhet të kenë tokë bujqësore me sipërfaqe minimale 0,1 deri në 0,30 ha për mbjelljen dhe rritjen e bimëve medicinale dhe aromatike.

Mbështetja konfirmohet në bazë të sipërfaqes së mbjellë me kusht që përqindja e zënies së fidanëve të jetë së paku mbi 80 %.

Mbështetja e prodhimit dhe zhvillimit të specieve specifike të bimëve të Ulqinit

Neni 8

Nxitjet përfshijnë mbështetjen e aktiviteteve që kanë të bëjnë me mbjelljen, prodhimin, ofertën dhe plasimin e specieve bimore sipas të cilave është i njohur Ulqini prej kohësh si:

1. kimçat,
2. shegat,
3. fiqtë,
4. mollët e japanit dhe agrumet.

Investimet e pranueshme:

- blerja e materislit mbjellës, në pajtim me dispozitat ligjore në këtë fushë.

Kushtet e pranueshmërisë

Shfrytëzuesit duhet të posedojnë tokë bujqësore për mbjelljen e fidanëve dhe të jenë të regjistruar në regjistrin e prodhuesëve bujqësorë (ekonomi bujqësore) të Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural. Fidanët duhen të jenë në një sipërfaqe minimale 0,10 deri 0,30 ha.

Me kërkesën për blerjen e materialit për mbjellje bashkangjitet deklarata për cilësinë e materialit për mbjellje.

Mbështetja e organizimit dhe zhvillimit e prodhimtarisë së bujqësisë organike

Neni 9

Nxitjet e organizimit dhe zhvillimit të prodhimtarisë së bujqësisë organike përfshijnë mbështetjen e aktiviteteve që kanë të bëjnë me investimet në zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore organike në cilindo segment të prodhimtarisë bujqësore. Objektivat e kësaj mase janë të përmbledhura në nevojën e rritjes së vlerës së shtuar të produkteve bujqësore përmes organizimit të prodhimtarisë së bujqësisë organike.

Investimet e pranueshme:

- Përkrahja e organizimit të prodhimtarisë organike në ullistari;
- Përkrahja e organizimit të prodhimtarisë organike në sektorin e blegtorisë;
- Përkrahja e ngritjes dhe pajimit me fidane prodhuese të pemëve dhe specieve specifike të bimëve të Ulqinit sipas standardeve për prodhimtari organike;
- Avancimi dhe organizimi i prodhimeve organike të bletëve.

Me nxitjet përfshihen aktivitetet në periudhën kalimtare për përfshirjen dhe përshtatjen e subjekteve në prodhimin organik dhe mbështetja e specifikimit të produkteve të gatshme organike, (mbështetja e ngritjes së fidanëve të rinj organikë, mbështetja e blerjes së plehrave organike, materialit për mbjellje të mjeteve të lejueshme për mbrojtje).

Kushtet e pranueshmërisë

Për realizimin e të drejtës për këtë mbështetje prodhuesit bujqësorë të jenë të regjistruar në regjistrin subjekteve në prodhimtarinë organike në pajtim me dispozitat në fuqi.

Mbështetja jipet për prodhimtarinë organike në çdo segment të prodhimtarisë bujqësore.

Kushtet për shfrytëzimin e këtij lloji të prodhimtarisë do të precizohen me thirrjen publike.

Mbështetja për prodhimin blegtoral

Neni 10

Mbështetja për prodhimin blegtoral realizohet me sigurimin:

- me blerjen e bagëtive mbarështuese

Kushtet e pranueshmërisë

1. Premia për blerjen e mështjerrave mbarështuese: të drejtë në përkrahje kanë prodhuesit bujqësorë të cilët merren me prodhimtari blegtorale. Premia jepet për blerjen e 5 krerëve të racës së pastër mbarështuese.
2. Shfrytëzuesit duhet të posedojnë objektet për mbajtjen e bagëtive dhe sipërfaqe bujqësore për prodhimin e sasive të mjaftueshme të ushqimit për kafshë.
3. Shfrytëzuesit duhet të jenë të regjistruar në regjistrin e prodhuesëve bujqësorë (ekonomi bujqësore) të Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Avancimi i bletarisë

Neni 11

Nxitjet përfshijnë mbështetjen e aktiviteteve që kanë të bëjnë me investimet për formimin ose zgjerimin e bletishtave dhe blerjen e pajisjeve për avancimin e veprimtarisë bletare.

Investimet e pranueshme

- Formimi ose zgjerimi i bletishtave me pajisjet përkatëse
- Premia për numrin e koshereve

Kushtet e pranueshmërisë

Shfrytëzuesit duhen të posedojnë tokë bujqësore për mbajtjen e shoqërive bletare.

Nëse objekt i investimit është formimi i bletishtave numri i shoqërive bletare në fund të investimit nuk mund të jetë më i vogël se 5, e nëse objekt i investimit është zgjerimi i bletishtave ekzistuese, numri i shoqërive bletare duhet të rritet së paku për 3 shoqëri.

Nëse objekt i investimit është blerja e shoqërive bletare për formimin e bletishtave për fillestarë mbështetet blerja deri në tre koshere.

Premia për numrin e koshereve ju takon të gjithë bletarëve.

Menaxhimi i rrezikut në bujqësi

Neni 12

Mbështetja për menaxhimin e rrezikut në bujqësi përbëhet nga:

- Kompensimi i dëmit që e kanë pësuar prodhuesit bujqësorë me rastin e vërshimeve, zjarrit, thatësisë, breshërit, sëmundjes dhe egërsirave.

Të drejtë për kompensimin e dëmit kanë prodhuesit bujqësorë të cilët kanë pësuar dëme.

Me kërkesën dorëzohet edhe raporti i Komisionit për vlerësimin e dëmit ose raporti i komisionit të ekspertëve.

Promovimi i bujqësisë dhe produkteve bujqësore

Neni 13

Promovimi i bujqësisë dhe produkteve bujqësore bëhet përmes mbështetjes së fushatave të ndryshme promovuese dhe programeve të cilat i propozojnë shoqatat e prodhuesëve bujqësorë:

- organizimi i panaireve, ekspozitave dhe manifestimeve të tjera me qëllim të prezantimit të produkteve dhe prodhuesëve bujqësorë në territorin e komunës së Ulqinit;
- pjesëmarrja në panaire, ekspozita dhe udhëtime studimore rajonale dhe ndërkombëtare;
- organizimi i edukimeve nga fusha e prodhimit të bujqësore dhe botimi i revistave profesionale nga fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Masat zbatohen në bazë të kërkesave vjetore të shfrytëzuesve potencialë dhe planeve dhe programeve të dorëzuara.

Përparësi kanë aktivitetet e promovimit në kuadër të manifestimeve tradicionale të cilat theksojnë specifikitetin e prodhimeve ulqinake në aspektin e cilësisë së tyre.

Krahas prodhuesëve të regjistruar bujqësorë shfrytëzues të këtyre nxitjeve mund të jenë edhe organizatat joqeveritare dhe shoqatat e regjistruara në bujqësi.

Me kërkesën për alokimin e mjeteve shfrytëzuesi paraqet programin dhe specifikimin e hollësishëm të shpenzimeve (për organizimin, panaireve të edukimit etj.) ose paralogarinë (për pjesëmarrje në panaire, ekspozita etj.).

Mbështetja e investimeve për ndërtimin e puseve, cisternave dhe sistemeve për vaditje

Neni 14

Mbështetjet e investimeve përfshijnë mbështetjen e aktiviteteve që kanë të bëjnë me shpimin, çeljen e puseve, investimet për blerjen, ndërtimin e puseve dhe cisternave, ndërtimin e sistemeve në zonat rurale pa ujë ose zona të tjera ku nuk ka burime uji.

Investimet e pranueshme:

- ndërtimi i infrastrukturës për vaditje (rrëmihja dhe ndërtimi i puseve, pishinave, cisternave, objektet e stacioneve të pompimit etj.),
- blerja e sistemit për vaditje (pompat, tubat e furnizimit me ujë, tubacionet e shpërndarjes e tjerë).

Kushtet e pranueshmërisë

Të drejtë në mbështetje kanë ekonomitë bujqësore të cilat posedojnë dhe punojnë prej 0,10 deri në 0,30 ha tokë.

Mbështetja në pjesën e ndërtimit të puseve do të jetë vetëm për ato investime ku gjendet uji.

Për të gjitha këto investime detyrimisht dorëzohet dëshmia (faktura) për pagesën e shpenzimeve të punimve të realizuara.

Mbështetja e bërjes së analizave të fryteve të pemëve dhe perimeve

Neni 15

Mbështetja e bërjes së analizave të fryteve të pemëve dhe perimeve që kanë të bëjnë me plasimin në treg.

Investimet e pranueshme:

- Analiza e gjendjes shëndetësore të bimëve (perimeve, pemëve, agrumeve e tjerë)

Kushtet e pranueshmërisë:

Mbështetja e bërjes së analizave për gjendjen shëndetësore të bimëve për nevojat e plasimit në treg dhe sigurimi i certifikateve ndërkombëtare në pajtim me dispozitat ligjore.

Mbështetja u jipet fermerëve të regjistruar në regjistrin e prodhuesëve bujqësorë (ekonomive bujqësore) të Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural.

III. MËNYRA E PROCEDURËS PËR REALIZIMIN E TË DREJTËS NË NXITJE

Neni 16

Të drejtën në stimulim e përfitojnë personat fizikë dhe juridikë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore të cilët e kanë vendbanimin, përkatësisht selinë në territorin e Komunës së Ulqinit (në vazhdim: shfrytëzuesit), të cilët veprimtarinë bujqësore e ushtrojnë në territorin e Komunës së Ulqinit.

Neni 17

Të drejtën për stimulim, personi nga neni 16 mund ta realizojë nëse:

- i plotëson kushtet e parapara me këtë Vendim,
- nuk ka obligime tatimore të pashlyera ndaj organeve të administratës lokale,
- për të njëjtin investim nuk është shfrytëzues i mbështetjes nga Ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural, përveç mbështetjes nga neni 13 i këtij Vendimi që kanë të bëjnë me promovimin e bujqësisë dhe produkteve bujqësore.

Kushtet për realizimin e të drejtës për stimulim duhet të plotëshen më së voni në momentin e shpalljes së thirrjes publike.

Neni 18

Me mjetet e stimulimit nuk kompensohen:

- blerja e pajisjeve të shfrytëzuara, përkatësisht përdorura,
- shpenzimet e tatimit, doganës, importit, taksat administrative dhe shpenzimet e ngajshme,
- blerja dhe marrja me qira e tokës bujqësore dhe objekteve ekzistuese,
- shpenzimet e mjeteve qarkulluese dhe shpenzimet operative,
- shpenzimet e punës së vet (të ardhurat, kontributet).

Neni 19

Kur si kusht i pranueshmërisë paraqitet posedimi i tokës ndërtimore, shfrytëzuesit duhen të posedojnë tokë bujqësore në pronësi të vet ose në pronësi të anëtarëve të familjes së tij.

Me anëtarë të familjes sipas këtij vendimi konsiderohen: bashkëshorti/ja, prindët dhe fëmijët të produktit të regjistruar bujqësor.

Nëse nuk posedon tokë të veten, shfrytëzuesi mund ta marrë me qira tokën bujqësore, për një periudhë jo më të shkurtër se 5 vite, duke filluar nga viti kalendarik për të cilin parashtrohet kërkesa për shfrytëzimin e stimulit.

Neni 20

Blerja e të gjitha llojeve të mallit, shërbimeve dhe punët mund të jetë e pranueshme për mbështetje vetëm nëse furnizuesi i mallit dhe kryesi i punimeve është person juridik i regjistruar për kryerjen e këtyre veprimtarive.

Neni 21

Një prodhues bujqësor në një vit mund të realizojë të drejtën në stimulim në disa degë të dnryshme, e më së shumti në një bazë në një degë të prodhimit.

Shuma e mbështetjes

Neni 22

Mbështetja sigurohet në shumën deri në 50 % nga investimi i pranueshmërisë për të gjitha investimet pa TVSH, me përjashtimet e mëposhtme:

- mbështetja për prodhuesit e rinj bujqësorë, jo më të rinj se 18 vjeç dhe jo më të vjetër se 25 vjeç, në shumën deri në 60 %, me detyrimin që të merret me prodhimtari bujqësorë në pesë vitet e ardhshme,
- shuma e mjeteve stimuluese për blerjen e materialit mbjellës është deri në 80 %, pa TVSH,
- mbështetja e bërjes së analizës së frytave të pemëve dhe perimeve në shumën deri në 50 %,
- kompensimi i dëmit që e kanë pësuar prodhuesit bujqësorë për shkak të fatkeqësive natyrore në shumën deri në 40 % të dëmit të vlerësuar.

Neni 23

Nëse shuma e përgjithshme e kërkesave të parashtruara për mjetet e caktuara stimuluese e tejkalon shumën e mjeteve të planifikuara me Buxhet, proporcionalisht zvogëlohet shuma stimuluese e njësisë, e nëse për mjetet e caktuara stimuluese nuk ka kërkesa të mjaftueshme mjetet e tjera të planifikuara mund të orientohen për një masë tjetër stimuluese.

Procedura për realizimin e të drejtës

Neni 24

Procedurën për realizimin e të drejtës për stimul e nisën organi kompetent me publikimin e thirrjes publike për alokimin e mbështetjes e cila publikohet në një gazetë ditore, në tabelën e shpalljeve dhe faqen e internetit të Komunës.

Thirrja publike duhet të përmbajë:

- llojet e stimujve,
- shumat për disa lloje të stimujve,
- shfrytëzuesit e mbështetjes,
- kushtet e parapara sipas llojeve të stimujve,
- dokumentet të cilët parashtruesi i kërkesës është i detyruar t'ia bashkangjës kërkesës,
- afatin e parashtrimit të kërkesave,
- edhe dëshmitë e tjera për faktet dhe rrethanat e nevojshme.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i stimujve që kanë të bëjnë me administrimin e risqeve në bujqësi: mbështetja e bërjes së analizës së fryteve të pemëve dhe perimeve; edhe promovimit të bujqësisë dhe produkteve bujqësore ndahen pa shpallje publike.

Menaxhimi i risqeve në bujqësi konstatohet në bazë të fakteve të dorëzuara për dëmin e pësuar dhe raportit të komisionit për fatkeqësitë natyrore ose raportit të komisionit profesional.

Mbështetja e bërjes së analizave të fryteve të pemëve dhe perimeve konfirmohet në bazë të dëshmimeve për fakturën e dorëzuar për analizë nga organi kompetent.

Promovimi i bujqësisë dhe produkteve bujqësore konfirmohet në bazë të programeve dhe planeve të dorëzuara për promovim.

Neni 25

Kërkesën për realizimin e të drejtës sipas thirrjes publike e parashtron personi nga neni 16 i këtij vendimi. Në rast të pamundësisë (rastet e sëmundjeve të rënda, trajtimit spitalor dhe shtëpiak etj.) në emër të shfrytëzuesit mund ta dorëzojë edhe anëtari i familjes, përkatësisht një person tjetër i autorizuar me prokurë të vërtetuar për përfaqësim me kusht që kërkesa është parashtruar në afatin e paraparë dhe të jetë në emër të prodhuesit të regjistruar.

Neni 26

Dokumentet që dorëzohen me kërkesën për realizimin e të drejtës për stimulim duhet të jenë në emër të parashtruesit të kërkesës dhe dorëzohen në original ose kopje të vërtetuar.

Të gjithë dokumentet e dorëzuar nuk duhet të jenë më të vjetër se 6 muaj nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Për mjetet dhe pajisjet e blera jashtë vendit kërkesës i bashkangjitet edhe dokumentacioni doganor përcjellës.

Neni 27

Shuma e stimulit konfirmohet pas përpunimit dhe përlllogaritjes së kërkesave të mbërritura për secilin lloj të stimulit në varësi nga numri i kërkesave dhe në pajtim me shumën e cila është konfirmuar me Planin e shfrytëzimit të mjeteve për nxitjen e zhvillimit të bujqësisë.

Sekretariati përpara miratimit të mjeteve financiare, viziton prodhuesit të cilët e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar dhe me shikimin në vend, bënë verifikimin e të dhënave dhe kushteve të parapara me këtë vendim dhe për këtë harton një procesverbal me vlerësim dhe mendim për përmbushjen e kushteve për shfrytëzimin e simujve financiarë.

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar dhe shikimit në vend sekretariati konstaton plotësimin e kushteve për realizimin e të drejtave për mjetet stimulative dhe me aktvendim u lejon pagesën e stimujve financiarë shfrytëzuesve.

Kërkesat jashtë afatit dhe ato jo të plota sekretariati nuk do t'i shqyrtojë.

Neni 28

Pagesa e mjeteve stimulative bëhet direkt në xhironlogarinë e shfrytëzuesit.

Obligimet e shfrytëzuesit

Neni 29

Shfrytëzuesit e të drejtës janë të obliguar që mjetet stimulative t'i shfrytëzojnë për qëllimin e caktuar dhe nuk mund t'i tjetërsojnë, e as t'ia japin një personi të dytë në shfrytëzim investimin i cili është subjekt i kërkesës, në një periudhë prej 5 vitesh nga dita e realizimit të drejtës.

Kontrollin e shpenzimit të mjeteve stimulative në kontinuitet e bënë organi kompetent për çështje të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Shfrytëzuesit të cilët mjetet stimulative i përdorin në mënyrë të papërshtatshme, që e konfirmon organi kompetent, e humbin të drejtën në mjetet stimulative për të cilën gjë sekretariati nxjerrë aktvendim të posaçëm me të cilin shfrytëzuesi do të urdhërohet të kthejë mjetet.

Në rast të shfrytëzimit të papërshtatshëm, shfrytëzuesi është i obliguar që në tërësi t'i kthejë mjetet e alokuara në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Personat të cilët kanë dhënë të dhëna jo të sakta me rastin e parashtrimit të kërkesës, që i konfirmon organi kompetent, nuk kanë të drejtë në mjetet stimulative.

Neni 30

Shfrytëzuesit e të drejtës duhen ta ruajnë dokumentacionin në bazë të cilit e kanë realizuar të drejtën në mjetet stimulative, më së paku pesë vite nga dita e marrjes së mjeteve stimulative.

IV. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 31

Me gjobë prej 150 € deri në 10.000 € do të gjobitet për shkelje organi nëse:

- mjetet për stimulim i ndanë pa shpalljen e thirrjes publike (neni 4, paragrafi 1);
- mjetet e stimulimit i ndanë në kundërshtim me mënyrën dhe procedurën e paraparë me këtë Vendim (neni 4, paragrafi 1);

Për shkeljen nga paragrafi 1 i këtij neni do të gjobitet edhe personi përgjegjës në personin juridik me gjobë prej 20 € deri në 1000 €.

Neni 32

Me gjobë prej 150 € deri në 10.000 € do të gjobitet për shkelje personi juridik nëse:

- mjetet stimuluese i shfrytëzon në mënyrë të papërshtatshme (neni 29, paragrafi 1);
- kanë dhënë të dhëna të pasakëta me rastin e parashtrimit të kërkesës (neni 29, paragrafi 5);
- nuk e ruan dokumentacionin që ka të bëjë me realizimin e të drejtës në stimulim së paku pesë vjet nga dita e marrjes së mjeteve stimuluese (neni 30).

Për shkeljen nga paragrafi 1 i këtij neni do të gjobitet edhe personi përgjegjës në personin juridik me gjobë prej 20 € deri në 1000 €.

Për shkeljen nga paragrafi 1 i këtij neni do të gjobitet edhe sipërmarrësi me gjobë prej 50 € deri 3000 €.

Për shkeljen nga paragrafi 1 i këtij neni do të gjobitet edhe personi fizik me gjobë prej 20 € deri 1000 €.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 33

Për realizimin e këtij Vendimi përgjegjës është Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik.

Obligimet ndaj shfrytëzuesve të programit do të zbatohen sipas dinamikës të konfirmuar me planin buxhetor të shpenzimeve për vitin në vijim.

Neni 34

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në “Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës”.

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numër: 02 – 60/19-5
Ulqin, më 18. 03. 2019

KRYETARI
Dr. Ilir Çapuni, d.v.